REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR

TIRANË

NR 781 AKTI

Dt.Regj.01.08.2019

VENDIM

"PËR SIGURIMIN E PADISË"

Gjykatesja e vetme e Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane:

Gjyqtar: Mimoza KAJO- BRAHIMI

Asistuar nga sekretare gjyqsore Suzana Murataj sot me dt 07/08/2019 mori ne shqyrtim në dhomë këshillimi kerkesën për sigurimin e padisë që i përket palëve:

KËRKUES: Albania Duty Free Distribution shpk, përfaqësuar nga administratori Z. Erjon Hastoçi, perfaqësuar me autorizim nga av. Merita Tabaku me nr license 1279.

OBJEKTI: Marrjen e masës për sigurimin e padisë për vazhdimin e aktivitetit në ambjentin ekzistues, zona e tranzitit ne aeroportin Nënë Tereza, deri ne zgjidhjen përfundimtare të padisë.

BAZA LIGJORE: Neni 202,203,204 e vijues i Kodit të Procedurës Civile, Kodi Doganor nenit 248 te tij ,Vendimi I Këshillit të Ministrave 651 dt 10.11.2017 dhe ligji per Koncesionet në Aeroportin e Rinasit.

Gjykata pasi dëgjoi pretendimet e palës kërkuese të përfaqësuar nga avokatja në seancë që kërkoi pranimin e kërkesës sipas objektit dhe shqyrtoi çështjen ne tërësi.

[shqiptarja.com]

VËREN

Se pranë kësaj Gjykate është paraqitur për shqyrtim kërkesa për sigurimin e padisë me objektin marrjen e masës për sigurimin e padisë për vazhdimin e aktivitetit në ambjentin ekzistues, zona e tranzitit ne aeroportin Nënë Tereza, deri ne zgjidhjen përfundimtare të padisë e cila do të paraqitet më vonë në kushtet kur gjykatat janë me pushimet vjetore dhe nuk hidhet shorti për paditë civile.

Bashkë me kërkesën ajo ka paraqitur edhe një kopje të kërkesëpadisë me objekt: *Detyrimin e palës së paditur për të rivendosur ne posedim ambjentin me siperfaqe 282 m2 per periudhën kohore nga data 27/08/2019 deri më datë 26/08/2024 nepermjet rilidhjes se kontrates se koncensionit ose në të kundërt dëmshpërblimin për dëmin e shkaktuar si pasojë e mos rilidhjes së kësaj kontrate për periudhën 5 vjecare të disponimit të licensës ku përfshihen dëmi i shkaktuar dhe fitimin e munguar, së bashku me dëmin moral.*

Nga shqyrtimi gjyqësor i cështjes rezulton e provuar si më poshtë:

Shoqëria Albania Duty Free Distribution shpk (ADFD shpk) me seli në Tiranë ka për objekt të veprimtarisë së saj: Ushtrimi i aktivitetit privat ne fushen e biznesit "Duty Free Shops",nepermjet importit te mallrave qe tregtohen ne kete rrafsh si parfume,kozmetike,aksesore te ndryshem, paisje elektronike,likerna dhe pije te ndryshme,cigare etj.hapje dyqanesh ne territorin e Shqiperise perfshire aeroportet,portet,njesite ne zonat kufitare dhe trupin diplomatik te akreditуar ne Shqiperi.

Kjo shoqëri ka një periudhë kohore prej më shumë se 21 vjetësh që operon në fushën e Duty Free – së në Rinas që e ushtron edhe në momentin aktual.

Gjatë kësaj periudhe marrëdhëniet midis shoqerisë ADFD shpk dhe Tirana International Airport (TIA) që ka me koncension aeroportin e Rinasit kanë qënë marrëdhënie kontraktuale korrekte dhe janë përmbajtur në mënyrë rigoroze nga ana e të dyja palëve.

Nga shqyrtimi gjyqësor dhe administrimi I provave dhe I pretendimeve te palës kërkuese rezulton që **licensa për ushtrimin e kësaj veprimtarie para vitit 2007 ka qënë pa afat kohor ashtu edhe kontrata e qerasë për ambientin ku operon ky subjekt.**

[Shqiparia.com]

Me ndryshimet e vitit 2007 të bëra në Kodin Doganor licensa dhe kontrata e qerasë për ambjentet për ushtrimin e aktivitetit në aeroport janë përcaktuar në një periudhë kohore 5 vjecare.

Nisur nga këto afate kohore rezulton që afati i kontratës së qerasë për ambientet në aeroportin e Rinasit nën koncesionin e kompanisë Kineze është lidhur për afatin 28.08.2014 deri më dt 27 Gusht 2019 në mesnatë.

Referuar Kodit Doganor në këtë datë normalisht duhet të përfundonte edhe licensa e shoqërisë ADFD shpk për ushtrimin e aktivitetit duty free ne këtë aeroport.

Kërkuesi parashtroi se nga ana e Ministrisë përgjegjese për Financat nuk është njoftuar lidhur me mos rinovimin e licensës.

Si rregull ky njoftim duhej të bëhej deri me dt 27 qershor 2019.

Në nenin 248 i Kodit Doganor dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr 199/2017 neni 638/2 thuhet: ".1. *Për qëllime sigurie, mbikëqyrjeje dhe kontrolli, magazinat doganore private (duty free shop), do të lejohen: a)në aeroportet për fluturime ndërkombëtare, maksimumi 2 (dy) duty free shop; b)në portin e Durrësit për destinacionet ndërkombëtare brenda zonës, 1 (një) duty free shop;*

2.Autorizimi për magazinat doganore private (duty free shop) është i vlefshëm për 5 vjet, me të drejtë rinovimi. ***Minimumi 60 ditë përpara përfundimit të afatit 5-vjeçar, ministri përgjegjës për financat duhet të njoftojë mbajtësin e autorizimit dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave lidhur me mosrinovimin e autorizimit.*** *Nëse ministri përgjegjës për financat nuk njofton mbajtësin e autorizimit, atëherë rinovimi konsiderohet i mirëqenë.*

Nga shqyrtimi i dispozitës së mësipërme rezulton se duke qënë se Ministri përgjegjës i Financave nuk ka sjellë asnjë njoftim për mosrinovimin e autorizimit në minimum 60 ditë përpara datës së përfundimit të autorizimit ekzistues në emër të shoqërisë ADFD shpk , pra përpara datës 27.06.2019, **autorizimi për Duty Free konsiderohet i rinovuar në bazë të ligjit.**

Sipas shkresës së Degës së Doganës së Rinasit nr.193/1 Prot date 18.01.2019 e cila është administruar në dosje kërkuesi ka qënë një subject korrekt në veprimtarine e tij tregtare.

Në lidhje me kërkesën object gjykimi gjykata cmon që tu referohet këtyre akteve ligjore:

Neni 202 I Kodit të Procedurës Civile

Me kërkesën e paditësit, gjykata brenda 5 ditëve lejon marrjen e masave për sigurimin e padisë, kur ka arsye të dyshohet se ekzekutimi i vendimit për të drejtat e paditësit do të bëhet i·

Shqiperia.com

pamundur ose i vështirë.
Sigurimi i padisë lejohet kur:
a) padia mbështetet në prova me shkresë;
b) paditësi jep garanci, në masën dhe në llojin e caktuar nga gjykata, për dëmin që mund t'i shkaktohet të padituri nga sigurimi i padisë.
Garancia mund të kërkohet edhe për rastin e parashikuar nga shkronja "a" e këtij neni.

Neni 203 I Kodit të Procedurës Civile

Sigurimi i padisë lejohet për të gjitha llojet e padive dhe në çdo fazë të gjykimit, derisa vendimi të marrë formë të prerë.

.....

Neni 204 Kodit të Procedurës Civile

Sigurimi i padisë mund të kërkohet edhe përpara ngritjes së padisë në gjykatën e vendit ku ka banimin paditësi ose ku ndodhet pasuria me të cilën do të sigurohet padia.

Në këtë rast gjykata cakton një afat jo më shumë se pesëmbëdhjetë ditë, brenda të cilit duhet të paraqitet padia në gjykatë.

Në lidhje me kërkesën objekt gjykimi gjykata cmon që të arsyetojë si më poshtë:

Kërkesa object gjykimi e paraqitur nga ana e palës kërkuese është në kompetencën e kësaj gjykate sipas nenit 36 e vijues te K.Pr.Civil dhe hyn në juridiksionin e mosmarrëveshjeve civile dhe jo të atij administrative apo të arbitrazhit kjo për faktin se konflikti rezulton që nuk ka të bëjë me kontratën ekzistuese në fuqi por me posedimin e ligjshem ambjenteve të marra me qera pas datës 27/08/2019.

Gjykata referuar e dispozitës ligjore të mësipërme cmon se shoqërisë ADFD shpk duhet ti jetë rinovuar licensa edhe për një periudhë tjetër 5 vjecare me datë fillimi 28/08/2019 ora 00.01 deri më 27/08/2024 ora 23.59 duke qënë se ndryshimet ne Kodin Doganor janë ndryshime që i përkasin një periudhe më të vonë se sa ligji për kontratat koncesionare.

Në rastin konkret rezulton se rinovimi I licensës nuk ka qënë I lidhur me pasjen përpara të një kontrate të vlefshme qeraje sic ka qënë në të shkuarën dhe ky rinovim I licensës rezulton që I është bërë subjektit të mësipërm për të njëtin ambjent dhe për të njëjtën sipërfaqe sipas licënsës ekzistuese prej 282m2 nga të cilat 235 m2 + 47,27 m2 në sallën e tranzitit Rinas për të cilën është bashkangjitur edhe planimetria dhe planvendosja e saj pa më të voglin ndryshim.

Kërkuesi pretendoi se se nga ana e TIA shpk , prona të së cilës janë një shoqëri me qendër në Hong Kong, janë hapur procedurat për organizimin e tenderit.

Këtë pretendim kërkuesi e mbështeti me printimin nga faqja online e TIAshpk ku në gjuhen angleze është publikuar propozimi për tender në ambjentet e Duty Free në TIA.

Shqiperia.com

Sipas kërkuesit ky tender deri ne momentin aktual nuk ka konkluduar me nje fitues .

Kërkuesi parashtroi se në kushtet kur jemi rreth 20 dite nga afati i perfundimit te kontrates koncensionare, dhe kur nga ana e administratoreve të TIA nuk është njoftuar nëse do të rinovohet marrveshja e koncesionit të Duty Free, kërkuesit I shkaktohet nje dem real dhe I konsiderueshem duke patur parasysh se ai ka kontrata specifike furnizimi me operatorë të tjerë të po kësaj fushe.

Gjykata e cmon sit ë drejtë dhe të bazuar këtë pretendim pasi kërkuesi paraqiti prova shkresore ku vërtetojnë shpenzimet e shumta për mbajtjen e aktivitetit dhe zhvillimin e tij.

Gjithashtu gjykata cmon që të nënvizojë se pavarsisht këtij argumenti edhe nëse TIA do të kishte apo do të përzgjidhte një operator tjetër për aktivitetin e Duty Free nëpërmjet nje tenderi, së bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr 199/2017 neni 638/2 sipas të cilit thuhet: ".1. *Për qëllime sigurie, mbikëqyrjeje dhe kontrolli, magazinat doganore private (duty free shop), do të lejohen: a)në aeroportet për fluturime ndërkombëtare, maksimumi 2 (dy) duty free shop;* operatorit tjetër mund ti japë një ambient tjetër por jo ambientin ekzistues dhe për të cilin shoqëria ADFD shpk ka të rinovuar licensen për vazhdimin e aktivitetit tregtar Duty Free per të njëtin ambient dhe sipërfaqe ekzistuese, pasi referuar licensës dhe planvendosjes e genplanit që shoqërojnë atë ambientet që I janë dhenë kerkuesit duhet të jenë në përdorim ekskluziv të tij.

Gjykata nisur nga rrethanat e mësipërme si dhe provat e paraqitura nga ana e palës kërkuese dhe konkretisht, inventari I mallrave gjendje në objekt, I investimit të kryer dhe fotografitë e paraqitura cmon se ka arsye të dyshohet se ekzekutimi i vendimit për të drejtat e paditësit do të bëhet I pamundur ose i vështirë, pasi deri në shtator 2019 në kryesekretarinë e gjykatës nuk hidhen në short kërkesëpadi e për rjedhojë nuk merren në shqyrtim kërkesëpadia e paraqitur bashkë me kërkesën object gjykimi.

Mbi sa më sipër që të mos ti shkaktohet një dëm i rëndësishëm, i pakthyeshëm dhe me një vlerë të konsiderueshme gjykata vendos marrjen e mases provizore për vazhdimin e aktivitetit tregtar Duty Free nga ana e shoqërisë ADFD shpk pas datës 27/08/2019 ora 23.59 deri në zgjidhjen përfundimtare të padisë me object *Detyrimin e palës së paditur për të rivendosur ne posedim ambjentin me siperfaqe 282 m2 per periudhën kohore nga data 27/08/2019 deri më datë 26/08/2024 nepermjet rilidhjes se kontrates se koncensionit ose në të kundërt dëmshpërblimin për dëmin e shkaktuar si pasojë e mos rilidhjes së kësaj kontrate për periudhën 5 vjecare të disponimit të licensës ku përfshihen dëmi i shkaktuar dhe fitimin e munguar, së bashku me dëmin moral.*

Në këtë rast gjykata në kuptim të nenit 204 paragrafi I dytë I K Pr C I cakton kërkuesit një afat prej 15 ditësh për të paraqitur në gjykatë padinë ndaj TIA shpk me object :*Detyrimin e palës së paditur për të rivendosur ne posedim ambjentin me siperfaqe 282 m2 per periudhën kohore nga data 27/08/2019 deri më datë 26/08/2024 nepermjet rilidhjes se kontrates se koncensionit ose në*

ISHPBARIMORE

të kundërt dëmshpërblimin për dëmin.e shkaktuar si pasojë e mos rilidhjes së kësaj kontrate për periudhën 5 vjecare të disponimit të licensës ku përfshihen dëmi i shkaktuar dhe fitimin e munguar, së bashku me dëmin moral.

PËR KËTO ARËSYE

Gjykata bazuar në kërkesat e nenit 202, 204, 205 e vijues të K. Pr. Civile

VENDOSI

-Pranimin e kërkesës së kërkuesit Albania Duty Free Distribution shpk.

-Marrjen e masës për sigurimin e objektit të padisë .

-Vazhdimin e aktivitetit në ambjentin ekzistues, zona e tranzitit ne aeroportin Nënë Tereza, pas datës 27/08/2019 ora 23.59 deri ne zgjidhjen përfundimtare të padisë me object: Detyrimin e palës së paditur për të rivendosur ne posedim ambjentin me siperfaqe 282 m2 per periudhën kohore nga data 27/08/2019 deri më datë 26/08/2024 nepermjet rilidhjes se kontrates se koncensionit ose në të kundërt dëmshpërblimin për dëmin e shkaktuar si pasojë e mos rilidhjes së kësaj kontrate për periudhën 5 vjecare të disponimit të licensës ku përfshihen dëmi i shkaktuar dhe fitimin e munguar, së bashku me dëmin moral.

-Gjykata në kuptim të nenit 204 paragrafi I dytë I K Pr C I cakton kërkuesit një afat prej 15 ditësh për të paraqitur në gjykatë padinë ndaj shoqërisë TIA shpk me object :Detyrimin e palës së paditur për të rivendosur ne posedim ambjentin me siperfaqe 282 m2 per periudhën kohore nga data 27/08/2019 deri më datë 26/08/2024 nepermjet rilidhjes se kontrates se koncensionit ose në të kundërt dëmshpërblimin për dëmin e shkaktuar si pasojë e mos rilidhjes së kësaj kontrate për periudhën 5 vjecare të disponimit të licensës ku përfshihen dëmi i shkaktuar dhe fitimin e munguar, së bashku me dëmin moral.

-Ky vendim është I ekzekutueshem ngá përmbaruesi gjyqsor.

Shqiperia.com

-Kundër ketij vendimi lejohet ankim I vecantë në Gjykatën e Apelit Tiranë.Afati I ankimit është 5 ditë nga e nesërmja e komunikimit të vendimit të arsyetuar.

-Ankimi ndaj këtij vendimi nuk pezullon ekzekutimin e tij.

-U shpall sot më date 07.08.2019.

SEKRETARE
SUZANA MURATAJ

GJYQTARE
MIMOZA KAJO-BRAHIMI

PULLE TARIFE

[Shqiptaria.com]